



I nderuar z. Kryeministër

I nderuar z. Ministër i Arsimit dhe Shkences

Të dashur kolegë e studentë të Akademisë së Arteve

Në këtë ditë të veçantë ju përshëndes dhe ju uroj mirëseardhjen në auditorët e shkollës sonë të artit.

Kam shumë dëshirë që, fillimisht të përshëndes dhe t'u uroj mirëseardhjen për herë të parë studentëve të viteve të para, të cilët do të jenë në vitet e ardhshme bashkëshoqërues dhe frymëzues të zhvillimeve e ndryshimeve akademike, kulturore e artistike të Akademisë së Arteve.

Njëkohësisht përgëzoj e falenderoj për kontributin real në këtë transformim të shkollës sonë, trupën pedagogjike dhe studentët. Ju falenderoj Ju të nderuar kolegë për gjithçka bëni përditë për edukimin profesional të artistëve të rinj. Unë e çmoj shumë rolin tuaj të padiskutueshëm.

Në emër të të gjithë juve studentë e pedagogë më lejoni që ti drejtojë një falenderim të veçantë dhe ti uroj mirëseardhjen Kryeministrit të Shqipërisë, z. Sali Berisha, i cili sot, me dashamirësi, përzgjedhi Akademinë e Arteve për të festuar fillimin e këtij viti të ri akademik. (Mireseerdhet Z. Kryeministër, mireseerdhët Z. Minister i Arsimit)

AA po përballet me sfida gjithnjë e më të mëdha, që prekin vetë studentët, punëdhënësit dhe shoqërinë. Synimi ynë strategjik është barazimi cilësor i veprimtarisë në shkallë rajonale e evropiane, duke çuar më tej atë traditë që e ka bërë këtë institucion një nga IAL-të shqiptare më konkurrenente në jetën skenike evropiane.

Përpjekjet tona janë drejtuar në rritjen e standardeve e të cilësisë së mësimdhënies dhe në përmirësimin e infrastrukturës akademike.

Akademia e Arteve është në një periudhë transformimi përsa u përket strukturave të saj dhe programeve. Pas një periudhe disavjeçare parapërgatitore ajo ka hyrë në fazën e përmirësimit të Kartës së Bolonjës. Ky është një proces që kërkon përkushtim dhe analizë të hollësishme e të kujdesshme të të gjithë faktorëve ndikues. Në këtë rrugë ne kemi hyrë duke e vlerësuar si më e frytshme për të na çuar në një model shkolle më të hapur e më konkurruese në botën e sotme.



Në këtë proces kemi pasur dhe kemi mbështetjen e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, sidomos për specifikat e punës tone gjate procesit metodik e krijues dhe kjo është e domosdoshme për të ardhmen e institucionit tonë. Vetë prania e sotshme e Zotit Kryeministër për ne është shprehje e një interesimi zyrtar gjithnjë në rritje e institucioneve dhe shtetit shqiptar për Akademinë e Arteve.

Unë gjej rastin t'i shpreh publikisht një falënderim të veçantë z. Kryeministër, për mbështetjen e fortë personale që i ka dhënë Akademisë së Arteve, lidhur me realizimin e projektit "Qyteti i Arteve", një projekt i cili është konceptuar si një konkurs për projekte artistike dhe që synon rritjen e konkurrencës në tregun artistik si dhe rritjen e mundësisë së personelit akademik dhe studentor që të prezantojnë arritjet më të mira krijuese dhe interpretuese të këtij institucioni.

Sa i takon infrastrukturës akademike, situata është problematike. Mjediset ku zhvillohet procesi akademik janë të amortizuara. Ne jemi të kënaqur që këtë vit të ri akademik studentët e fakultetit të arteve të bukura do të fillojnë studimet në mjedise të rinovuara. Por mbetet për zgjidhje urgjente pjesa tjetër e mjediseve tona.

Jemi duke bërë përpjekjet maksimale për hartimin e një projekti të plotë për rikonceptimin tërësor të mjediseve të Akademisë së Arteve, në përputhje me standardet më të përparuara për shkollat e larta. Por për këtë ne presim nga Qeveria mbështetje me investime.

Në kuadër të reformës në arsim po diskutohet shumë për mënyrën e financimit të Universiteteve. Do të shprehja mendimin se Akademia e Arteve duhet të trajtohet në mënyrë të diferencuar nga IAL e tjera. AA është një shkollë me kosto të lartë të studimit, ndërkohë që numri i studentëve është mjaft i vogël.

Në përfundim doja t'ju bëja të ditur se kemi nisur një diskutim shkencor për ndryshimin e emrit të tanishëm të Akademisë së Arteve. Oferta akademike e shpallur nga ne, programet mësimore, struktura e fakulteteve dhe gjithë parametrat akademik e bëjnë shkollën tonë realisht një universitet. Përfitoj nga rasti që dhe për këtë çështje të kërkoj mbështetjen e z. Kryeministër dhe të Qeverisë, për finalizimin sa më të shpejtë e të suksesshëm të kësaj iniciative.

Kam kënaqësinë të ftoj z. Kryeministër të marrë fjalën.